

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit Sh.K. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.1086/2013 të dt.28.03.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt. **16.06.2016** në prezencën e të akuzuarit Sh.K., dhe prokurores të shtetit Besa Krajku, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

SH.K. nga i ati Z. dhe e ema M., e vajzerise K., i lindur me *data e lindjes*...nga P. ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i biznesit për Kontrollim teknik të automjeteve, “K.P.” i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr personal: *numër personal*....

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:I pandehuri me datën 01.11.2013 ne rrugen “Rexhep Luci” në Prishtinë deri sa kishte qenë duke dalë nga vetura ,nga brezi ju kishte ekspozuar arma- pistoleta e tipit “BroWing”,patente depose cal.7.65mm, me ngjyrë te zezë të cilen gjë e kishin vërejtur policia që kishin qenë në një kafiteri në aferi dhe më pas e njejta armë është konfiskuar nga policia.

-me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve:2,3,7,14,41,42,43, 45 ,62,69, 73 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, i shqiptoi **DENIM ME GJOBË** në shumën prej 700 (shtatëqind) euro të cilën shumë i njejtë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmëris se ketij akgykimi.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 te KPPRK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zavendësoi me denim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPPK-se, ashtu qe gjdo 20 € (euro) , të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

DENIMIM PLOTËSUES

Konform nenit 62 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 të KPRK-së të akuzuarit i konfiskohet arma- pistoleta e tipit "Browning" patente, depozituar në kalibër 7.65mm, ngjyre e zezë.

I akuzuari **Sh. K.**, obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **50 € (tridhjet) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.1086/2013 të dt: 28.03.2014, kundër të akuzuarit Sh. K. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 16.06.2016 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sçarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, vazhdoi me shqiptimin e denimit me datën:16.06.2016, duke marr parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, gjendejn familjare si dhe gjendjes ekonomike. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njejtin do të shërbej si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues është marrur konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.169/14, të dt. 16.06.2016

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate